



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-132
17.04.2025
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Njoftimin për ndërprerjen e transmetimit të shërbimit programor në radio përmes radiofrekuencave nga Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti Shtetëror „GOCE DELÇEV“ Shtip – Institucion Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM, datë 03.04.2025, Deklaratën numër UZP 1128/2025 datë 10.04.2025 (i ynë PA1 nr.08-129 datë 11.04.2025) nga personi i autorizuar – rektori i Universitetit Shtetëror „GOCE DELÇEV“ Shtip dhe Konkluzionin ark.nr.02-1752/4 datë 16.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 17-të mbajtur më 16.04.2025 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i transmetuesve

1. FSHIHET nga regjistri i transmetuesve, Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti Shtetëror „GOCE DELÇEV“ Shtip – Institucion Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM.
2. Aktvendimi botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti Shtetëror „GOCE DELÇEV“ Shtip – Institucion Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM (në tekstin e mëtejme RADIO UNIVERSITARE UGD FM), është zotërues i lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-135 datë 07.09.2023, që transmeton program përmes transmetuesit tokësor – radio frekuencave, në nivel lokal në zonën e komunës së Shtipit, shërbim programor destinuar për studentët, në gjuhën maqedonase.

Më 03.04.2025, në adresën zyrtare elektronike (contact@avmu.mk) të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) RADIO UNIVERSITARE UGD FM Shtip, ka dërguar Njoftim se do të ndërpresë me transmetimin e shërbimit programor në radio përmes radiofrekuencave (91.0 MHz) dhe do të vazhdojë transmetimin online në formë digjitale. Si shtojcë të njoftimit është dorëzuar Vendimi për ndryshimin e formës të Radios Universitare UGD-FM nga tradicionale në formë online digjitale, ark.nr.0201-281/3 datë 28.03.2025 miratuar nga senati i Universitetit Shtetëror „GOCE DELÇEV“ Shtip, sipas të cilit

ndryshimi ka rezultuar nga nevoja për rritjen e digjitalizimit dhe modernizimit të radios në pronësi të Universitetit. Konkretisht, mediat e reja digjitale (faqe e re ueb sajti e riemëruar për të rinjtë, platforma të reja të rrjeteve sociale duke përfshirë TikTok, si dhe profile të reja në Facebook dhe Instagram, kanal komunikimi përmes bashkësisë Viber, video podcasti dhe të ngjajshme), kanë tërhequr një numër të dukshëm të ndjekësve aktiv, si dhe studentë, në krahasim me radion universitare që nuk ka mundur të arrinte këtë numër të ndjekësve, prandaj investimi i mëtejshëm për transmetim përmes radiofrekuencave ishte i papërshtatshëm. Në raport thuhet gjithashtu se në afat sa më të shkurtër kohor personi i autorizuar – rektori i RADIOS UNIVERSITARE UGD FM do të dorëzojë deklaratë të noterizuar, në të cilën do të thuhet se RADIO UNIVERSITARE UGD FM, do të ndërpresë me transmetimin e shërbimit programor në radio përmes radiofrekuencave, duke paraqitur datën e saktë të ndërprerjes me transmetim të programit në radio.

Me datë 11.04.2025 në adresën zyrtare elektronike (contact@avmu.mk) të Agjencisë nga RADIO UNIVERSITARE UGD FM nga Shtipi, është dorëzuar Deklaratë e noterizuar numër UZP 1128/2025 datë 10.04.2025 (i ynë PA1 nr.08-129 datë 11.04.2025) nga personi i autorizuar – Rektori Prof. Dr. Dejan Mirakovski, që Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti Shtetëror „GOCE DELÇEV” Shtip – Institucion Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM nga data 14.04.2025 ndërpre me transmetim të shërbimit programor në radio përmes radiofrekuencave (91.0 MHz). Transmetuesi në fjalë nuk ka borxh ndaj Agjencisë në bazë të kompensimit vjetor të lejes për transmetim në radio.

Në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV, leja për transmetim në radio ndalon së vlefshmi sipas ligjit me deklaratën me shkrim të zotëruesit që njofton Agjencinë për ndërprerjen me transmetim të programit në radio. Për ndalimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim televiziv ose radio sipas ligjit Këshilli nuk merr vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse leja ka ndaluar së vlefshmi sipas ligjit (neni 85 paragrafi 2 të LSHMAAV).

Rrjedhimisht nga sa më sipër, dhe duke pasur parasysh nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, me dorëzimin e deklaratës me shkrim të lartpërmendur nga personi i autorizuar – rektori i Universitetit Shtetëror „GOCE DELÇEV” Shtip, janë plotësuar kushtet ligjore për ndalimin e vlefshmërisë së lejes sipas ligjit, pas së cilës Agjencia do të fshijë transmetuesin, Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti Shtetëror „GOCE DELÇEV” Shtip – Institucion Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM nga regjistri i transmetuesve.

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe neni 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Njoftimin datë 03.04.2025 për ndërprerjen e transmetimit të shërbimit programor në radio përmes radiofrekuencave nga Republika e Maqedonisë së Veriut – Universiteti Shtetëror „GOCE DELÇEV” Shtip – Institucion Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM datë 03.04.2025, Deklaratën numër UZP 1128/2025 datë 10.04.2025 (i ynë PA11 nr.08-129 datë 11.04.2025) nga personi i autorizuar – rektori i Universitetit Shtetëror „GOCE DELÇEV” Shtip dhe Konkluzionin ark.nr.02-1752/4 datë 16.04.2025, u miratua aktvendim si në dispozitiv i cili hyn në fuqi menjëherë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetaari i Këshilli,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.